

V E N D I M
Nr.474, datë 14.10.1999

PËR NDRYSHIM NË LIMITIN E FONDEVE TË KUSHTËZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1999”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të rritet limiti i fondeve të kushtëzuara për Komitetin Shqiptar të Birësimeve në masën 1.5 milionë lekë në zërin “investime” për vitin 1999.
 2. Ky fond të përballohet nga limiti i miratuar i fondeve të kushtëzuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
 3. Ngarkohet aparati i Këshillit të Ministrave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko